

**Kryetari i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Haxhi Arifi, së bashku me përfaqësues të tjerë kanë mbajtur takim me përfaqësuesin ekspertit sindikal të Sindikatave Evropiane , Peter Seideneck, ku është shqyrtuar mundësia e anëtarësimit të BSPK në këtë familje të madhe evropiane.**

Arifi ka thënë se përfaqësuesi i konfederatës evropiane, ka ardhur që ta ndihmojë BSPK-në, të jetë anëtare në artë shtëpi.

“Shteti jonë nuk është i pranuar në Kombet e Bashkuara dhe ne si BSPK nuk jemi në konfederatën evropiane. Ky ka ardhur me një mision që BSPK të jetë anëtare edhe në atë shtëpi që veç na takon. Ne do të njoftohemi më për së afërmi nga ky se cilat janë planet”, ka thënë Arifi.

Ndërsa, përfaqësuesi i konfederatës evropiane, Peter Seideneck, ka thënë se edhe pas një kohe shumë të gjatë në Kosovë, BSPK i ka problemet dhe vështirësitë e njëjta.

Ai ka thënë se Sindikatat në Kosovë meritojnë një vend më akomodues.

“Pas kthimit tim në Kosovë pas një kohe shumë të gjatë po e shoh se Bashkësia Sindikale në Kosovë prapë paska vështirësitë e njëjta që gjenden në këto zyre që i përkasin qeverisë, ndërsa në të kaluarën i përkisnin BSPK-së. Tani BSPK i ka vetëm dy zyre të vogla këtu dhe kjo tregon që sindikatat në Kosovë kurrë nuk e kanë pasur një periudhë të mirë bile ta kenë një lokacion ku të vendosen”, ka thënë Seideneck.

Seideneck ka thënë gjatë këtij takimi do ta bëjnë një plan që BSPK-ja të përgatis agjendën Evropiane.

“Ajo çfarë do të bëjmë ne sot gjatë këtij takimi një ditore është që ne do të krijojmë një plan. Sindikatat evropiane do ta ndihmojnë BSPK-në, të përgatisim një agjendë evropiane”, ka thënë Seideneck.

Sipas tij, kjo do të jetë një rrugë e gjatë për proceset që do të kaloj Kosova. Ai ka thënë se konfederata evropiane e ka përkrah punën dhe angazhimin e baroneshës Catherine Ashton, për nënshkrimin e marrëveshjes mes dy qeverive të Kosovës dhe Serbisë.